

VENDIM
Nr. 7, datë 25.3.2022

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË
NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të neneve 21/3 dhe 21/5 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre”,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve për datën 26–28.3.2022, si më poshtë:

- 227 lekë/litri për gazoilin;
- 208 lekë/litri për benzinën.

2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve për datën 26–28.3.2022, si më poshtë:

- 233 lekë/litri për gazoilin;
- 218 lekë/litri për benzinën;
- 93 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

4. Ky vendim për miratimin e çmimeve tavan, sipas pikave 1 dhe 2, i fillon efektet më datë 26.3.2022 deri më datë 28.3.2022.

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj,

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi